




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 18 – 8557 – 1-3-6/C153
14 Nr. 1295/18
Dt. 12.12.2018

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. **NTP “ Dani Comerc “** me seli në **Vushtrri** , me **NRB: 80202300** dhe **Nr. Fiskal: 600169503**, si **Operatorë Ekonomik**, të cilën e përfaqëson: **z. Fehmi Spanca**, në tekstin e mëtejshëm **SHITËSI - FURNITORI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon: **Furnizimi me stufa për shkolla**, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	8	85	5	7	1	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	8	2	2	1	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me stufa për shkolla**, në sasi dhe cilësi sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-18-221-136**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **10 ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës**.
- 2.2 Vendi i dorëzimit të stufave është : në pajtim me nenin II – Qëllimi i kontratës pika II.5 të Dosjes së Tenderit, sipas regjistrat të Njesisë kërkuese dhe sipas Specifikimit Teknik pjesë e Dosjes së Tenderit. Verifikimi i cilësisë dhe sasisë së furnizimeve do të bëhet nga Komisionit të Pranimit të Mallit, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit – Pajisjeve të Autoritetit Kontraktues.
- 2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që mallin e kontraktuar ta dërgoi dhe montoi , me shpenzime dhe mjet transporti të tija, deri te vendi i saktësuar nga Njësia Kërkuese – Shpenzuese.

- 2.4 Furnizuesi do të penalizohet me shumën prej 0,25% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të kryerjes së furnimeve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.
- 2.5 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.6 Garancia për cilësinë e mallit të pranuar do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranim – dorëzimit të mallit dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 3.663,00€(tremijgashqindgjashtdhjetetre/00€).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht pas Pranimi të pajisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

- 4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (d) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit
- (e) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

- 4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

- 5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

- 5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

- 5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.


dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:	
Data:	12.12.2018
Vula:	


Për Kontraktuesin - Furnizuesin:

Emri:	Fehmi Spanca
Pozita:	Përfaqësues i : NTP " Dani Comerc " – Vushtrri
Nënshkrimi:	
Data:	12.12.2018
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënim: çmimin duhet ta shkruani me dy decimate pas presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi DDP -€	Totali €
1	Furnizimi me stufa nga argjila me dimensione minimum 85x40x56cm 9për dru dhe thengjill)	Copë	22.00	155	3410 ⁰⁰
2	Furnizimi me Qynka me gjatësi 1m të emailuara	Copë	22.00	4	88 ⁰⁰
	Furnizimi me Qynka me gjatësi 50cm të emailuara	Copë	22.00	2.50	55 ⁰⁰
2	Furnizim me Bërryla të emailuar	Copë	44.00	2.50	110 ⁰⁰
TOTALI I PËRGJITHËSHEM:					3663 ⁰⁰



IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	MP, Dani Covece
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT	Fehmi Spence
NËNSHKRIMI:	<i>[Signature]</i>
DATA:	12.11.2018

[Handwritten signature]